



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:019181

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01533472

P. nr.60/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z. I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1013/2017 të datës 09.08.2017 në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **11.02.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla, të akuzuarit, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit K. – A. K., me datën **12.02.2021** mori dhe shpalli ndërsa me dt.23.02.2021,përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Z. I.** nga i ati R. dhe e ëma Z. e gjinisë B., data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, tani me banim në Gjakovë, rr. ‘ . . . lagja Dardania p.n, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 364 par. 1 nën par.1.3 të KPPK-së:

LIROHET NGA AKTAKUZA

Kinse: Nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 18.12.2016, në shtëpinë e tij në rr. ‘ . . . ’ pn në Gjakovë, me qellim që vetës ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që në njehsorin elektrik nr.63841411, ka ndërhyrë në parametër skemë, duke manipuluar softverin, ku në njehsor nuk paraqitet T0 dhe T4, me këto veprime e ka penguar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertët e Qendrës së Kalibrimit – Divizioni i Rrjetit në Prishtinë, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar K. – divizioni Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumë prej 290.83 €.

-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1te KPRK-ës.

E dëmtuara K. – Divizioni në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.1013/2017 të datës 09.08.2017 kundër të akuzuarit Z. I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 par.1 të KPRK-së, me propozimin që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të Ligjit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese me P.nr.513/17 te dt.11.09.2018 ka marr aktgjykim liruës ndaj te akuzuarit Z. I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, meqenëse nuk është vërtetuar me asnjë nga provat materiale dhe as nga dëshmitë e dëshmitarëve se i njëjti ka kryer veprën penale me te cilën ngarkohet. Gjyqtarja ka caktuar shqyrtimin gjyqësor pas marrjes aktvendimit te Gjykatës se Apelit ne Prishtine PA1.nr.1140/18 te dt.13.12.2018me te cilën është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Gjakove, P.nr.513/17 te dt.11.09.2018 dhe lënda është kthyer gjykatës se shkalles se pare ne rivendosje.

Ne shqyrtimin gjyqësor prokurori i shtetit pasi lexoi aktakuzën beri rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 te KPRK-ës ne veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1te KPRK-ës, komfor nenit 3 te KPRK-ës, duke marr parasysh faktin se ne rast se ligji ne fuqi ndryshon para shqyrtimit te vendimit te formës se prere atëherë ndaj kryesit te veprës penale zbatohet ligji qe është me i favorshëm për te akuzuarin.

Ne shqyrtimin gjyqësor i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet, prandaj shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar ne administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit Mone Syla në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi, tani në këtë fazë deklaroi se jam shumë e bindur se i akuzuari Z. I. nuk ka dijeni për të ndërhyrë vetë por neve gjer me tani në bazë të ekspertizave nuk kemi mundur që të vërtetojmë gjendjen faktike për shkak se ekspertja e ekspertizës së fundit V. A. ka qenë shumë e pa qartë në deklarimin dhe eloborimin e ekspertizës së saj, pasi që e njëjta nuk na ka bind se si mund të bëhet ndërhyrja në softwer si në rastin konkret, andaj meqenëse kërkesa për një ekspertizë tjetër u refuzuar nga ana e gjykatës mbesë pranë aktakuzës dhe kërkoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të obligohet në shpenzimet e procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i K.-distrikti në Gjakovë, A. K. në fjalën përfundimtare deklaroi, se kam përgatitur fjalën përfundimtare me shkrim dhe nga një kopje ju dorëzoi palëve në procedurë, dhe i propozoj Gjykatës qe e njëjta të bashkëngjitet në shkresat e lëndës dhe te jete pjese përbërëse e shkresave te lendes.

I akuzuari Z. I. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se: sërish betohem para gjykatës se një vepër të tillë nuk e kam bërë, po ta kisha bërë që në fillim e kisha pranuar fajësinë, dhe ju kisha lutë juve si gjyqtare që të më lironi nga përgjegjësia penale, pasi që në lëndë keni tri ekspertiza të cilët kanë dhen mendimin përfundimtar se unë nuk jam fajtor për këtë vepër penale dhe këto ekspertiza janë bërë sipas propozimit të prokurores dhe përfaqësuesi të autorizuar të K.

e jo nga unë, andaj propozoi që të merr parasysh këto ekspertiza gjyqtarja dhe të më liroi nga përgjegjësia penale.

Konstatimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Z. I. ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Deri te ky konstatim Gjykata ka ardhë pasi ka analizuar të gjitha provat si dëshmitë e dëshmitarëve V. P., T. M., punëtor të autorizuar të Qendrës së kalibrimit në Prishtinë, dëshmitarëve L. M., Nd. Dh., punëtor të autorizuar të K.-it në Gjakovë, procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me numër 0672073 të datës 30.01.2017 lëshuar nga K.-Distrikti në Gjakovë, protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik numër 02 nr.2299 të datës 14.02.2017 të lëshuar nga sektori i qendrës së kalibrimit Prishtinë, procesverbali me nr.13118277 të lëshuar nga K. – Distrikti në Gjakovë, kalkulimi RH me numër të rastit 102849 datës 23.02.2017 lëshuar nga K. në Gjakovë – divizioni i furnizimit, faturat mbi llogaritjen e dëmit me numër DGJ 17 HP06570 të datës 23.02.2017 lëshuar nga K. – Distrikti në Gjakovë, shkresa e lëshuar nga M. Sh. – Drejtor i protokollit të produkteve të zonës ISKRAMECO dd, e lëshuar në Tetor të vitit 2020, e sidomos nga ekspertiza e njehsorit elektrik me nr.63841411 e lëshuar nga ekspertët e elektroenergjetikës Prov.msc.M.Sh., Msc.A. M. dhe msc.R. H. i dt.21.02.2020, si dhe ekspertiza e njehsorit elektrik me nr.63841411 tipit MTI74 i prodhuesit Iskra në Slloveni e lëshuar nga Agjensioni i metrologjisë së Kosovës me dt.25.08.2020 si dhe shkresave tjera përbërëse të lëndës.

Deklaratat e dëshmitarëve

Sipas propozimit të akuzuarit dhe pajtimit të palëve tjera në procedurë është aprovuar propozimi i të akuzuarit që deklaratat e dëshmitarëve V. P. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me dt.02.08.2018, deklarata e dëshmitarës T. M. punëtore e Qendrës së kalibrimit në Prishtinë, punëtorëve të autorizuar të K.-it Gjakovë, L. M., Nd. Dh., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt.10.09.2018 të lexohen dhe të administrohen si prova në shqyrtimin gjyqësor.

Dëshmitari V. P. gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me dt.02.08.2018, deklaroi se tani jam koordinatori i Qendrës së kalibrimit, por për kohën kur është kryer vepra e cila shqyrtohet në këtë shqyrtim gjyqësor unë kam qenë anëtar i komisionit të qendrës së kalibrimit. Në pyetjen e prokurorit përgjigjet se softveri është një program që është instaluar në njehsorin elektrik digjital ku bëhen disa programime në njehsor si për shembull tarifa (tarifa me të lirë dhe me të shtrenjtë) dhe koha kur ka me dalë shpenzimi i energjisë me të lirë dhe me të shtrenjtë, dhe çdo prekje në njehsorin elektrik digjital nga jashtë dhe nga brenda regjistrohen në softverin e cili është i programuar në njehsorin elektrik. Fillimisht është një tavolinë testuese ku bëhet matja e saktësisë së energjisë elektrike, gjatë testimit kemi konstatuar se ka ndërhyrje parametër skem me dt.18.12.2016, është bërë ndërhyrja në parametër skem të këtij njehsori elektrik dhe këtë e kemi vërtetuar nga i leximi i softverit që ka pasur ndërhyrje nga

jashtë. Po ashtu sqaron se kjo ndërhyrje bëhet me ndonjë kompjuter dhe është një sond (sistem komunikativ) ku me atë ka bërë ndërhyrje në parametrin, do të thotë shpenzimin për një kohë të caktuar e ka qitë në T4 ku nuk shifet në display, do të thotë me e shpenzuar energjinë elektrike me të lirë dhe nuk shifet në ekran kur punëtoret e K. e bëjnë regjistrimin e kilovatëve dhe nuk faturohet dhe në këtë mënyrë manipulohet me njehsorin elektrik digjital. Thekson se është proces i ndërlikuar dhe këtë ndërhyrje mund të bën vetëm personi që ka njohuri kompjuterike dhe i shkolluar për këtë ndërhyrje. Njehsori është programuar në fabrikë me dt.22.08.2014 ku edhe është prodhuar njehsori, kurse ndërhyrja në parametër skem është bërë me dt.18.12.2016 mbas dy vite. Dua të shtoi që personi që ndërhyr në njehsorin digjital fillimisht duhet të dij passwordin e që këtë password e ka vetëm fabrika që e ka prodhuar atë njehsor elektrik, prandaj personi duhet me qenë tejet tejet i kualifikuar dhe me njohuri përkatëse kompjuterike që të mund të thyej passwordin dhe të ndërhyr nga jashtë në këtë njehsor elektrik. Në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës K., B. J. dëshmitari përgjigjet se njehsori ka qenë i prodhimit “Iskra” me MT174 me numër të njehsorit 63841411, njehsori elektrik kur ka ardhë në testim ka ardhë pa shifër dhe pa emër të konsumatorit, në të cilën kemi konstatuar që është shpenzuar 2930 kilovatë. Në pyetjen e gjykatës lidhur me mjetet që i përdorin për konstatimin e manipulimeve të tilla dëshmitari u përgjigj që softwerin të cilën na siguron Iskra prodhuesi i njehsorit dhe i kemi trajnimet nga fabrika Iskra ku na lejohet që të marrin të gjitha shënimet e njehsorit nga softweri të cilën e ka vendosur fabrika Iskra dhe e ka programuar, shton se në rastin konkret thyerja e passwordit është bërë me dt.18.12.2016 në ora 20.03,26 seconda ndërsa është thyer po të njëjtën kohë por në ora 23.51 sekonda dhe si provë ia prezentoj gjykatës konstatimin e tillë të cilën e kemi marr nga softweri respektivisht leximi i softwerit të Iskres.

Dëshmitarja T. M. gjatë dëshmisë së saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor te dt.10.09.2018, deklaroi se kam qenë anëtare e komisionit kur është bërë kalibrimi i njehsorit në fjalë. Kur njehsori digjital vjen në kalibrim futet në tension i merren shënimet softwerike përmes lap topit mandej kryhet testimi lidhur me matjen e saktë të energjisë së shpenzuar. Por për këtë njehsor është konstatuar se matja është bërë e saktë por ka pasur ndërhyrje në parametër skem si dhe në programin tarifor. Ndërhyrja konkrete në këtë njehsor është bërë ashtu që se ky njehsor elektrik i ka T1(tarifa e shtrenjtë),T2(tarifa e lirë)dhe tarifa T4(e cila nuk shfrytëzohet dhe nuk tarifohet në K.)pasi që në këtë tarifë nuk bëhet regjistrimi i energjisë së shpenzuar por vetëm në T1 dhe T2,ndërsa në rastin konkret është konstatuar se shpenzimi i energjisë elektrike është tarifuar edhe në T4,pra një pjesë e shpenzuar në kilovat 2930 kilovat,e cila nuk është faturoar dhe se ky regjistrim i kilovatëve të rrymës së shpenzuar në tarifën T4 është bërë kur është ndërhyr në këtë njehsor do të thotë nga data 18.12.2016 e gjer kur është bërë ndërrimi i njehsorit me dt.30.01.2017, këtë ndërhyrje e kemi konstatuar në bazë të leximit softwerike në laborator të Qendrës së Kalibrimit .Kjo ndërhyrje bëhet me pajisje elektronike me llap top(kompjuter) dhe me një sond. Në pyetjen e gjykatës dëshmitarja përgjigjet se këtë ndërhyrje nuk mund ta bëj çdo person, duhet me pas njohuri tejet profesionale kompjuterike sepse fillimisht duhet me thye passwordin e pastaj me vazhdua me ndërhyrje kompjuterike në njehsor.

Dëshmitari L. M. gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor te dt.10.09.2018,deklaroi se mua se bashku me dy kolegë të tjerë na është dhënë urdhër që të bëjmë ndërrimin e njehsorit elektrik pasi që nga ana e lexuesit përmes pajisjes sonda(leximi i njehsorit elektrik)është konstatuar ndërhyrje në këtë njehsor, prandaj na kanë urdhëruar që të bëjmë ndërrimin e njehsorit më qëllim që ta dërgojmë në qendrën e kalibrimit sepse është konstatuar një ndërhyrje. Gjatë ndërrimit të njehsorit ne nga ana e jashtme nuk kemi vërejte ndonjë ndërhyrje. I akuzuari ka qenë prezent dhe ka nënshkruar procesverbalin.

Dëshmitari Nd. Dh. gjatë dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor te dt.10.09.2018, deklaroi se së bashku me kolegët e tij kanë marrë urdhër nga punëdhënësi të ndërrojnë njehsorin pasi që ka pasur informata nga lexuesi i njehsorit elektrik se në këtë njehsor është shenja MC, e kemi hequr njehsorin e vjetër dhe kemi vendosur njehsorin e ri. Të vjetrin e kemi dërguar për kalibrim. Në pyetjen e të akuzuarit a ka pasur ndërrime të kësaj natyre dikush tjetër në lagje, dëshmitari përgjigjet se jo vetëm tek njehsori i të akuzuarit është bërë ndërrimi për arsyet e lartcekura.

Duke vepruar në bazë të sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjyqtarja ka lëshuar urdhëresë Fakultetit të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike në Prishtinë me dt.21.08.2019 të njëjtën e ka përsërit me dt.12.09.2019, por administrata e fakultetit nuk i ka pranuar shkresat e lëndës që të bëjë super ekspertizën, pas shumë përpjekjeve administratori i Gjykatës R. E. me dt.10.12.2019, njofton se është tentuar disa herë dorëzimi i urdhëresës bashkë me shkresat e lëndës, mirëpo të njëjtit nuk i kanë pranuar me arsyetim se nuk janë kompetent, tentimi është bërë disa herë radhazi përmes vozitësit të gjykatës, refuzimi nga ana e fakultetit është bërë verbalisht asnjëherë me shkrim. Në këtë situatë me qëllim të zgjidhjes së kësaj qeshje juridiko penale Gjyqtarja e vetme gjykuese ka caktuar tre ekspert të pavarur të lëmis përkatëse, që të bëjnë super ekspertizën e njehsorit elektrik me nr.63841411, ne lidhje me atë se a ka pasur mundësinë e ndërhyrjes në baza softwerike në njehsorin digjital nga i akuzuari apo nga personat e trete, gjithsesi duke vlerësuar edhe mundësinë e ndonjë gabimi (prishje) të njehsorit elektrik digjital. Në bazë të urdhëresës sonë në Gjykatë kemi pranuar ekspertizën e kryer nga ekspertet e elektroenergjetikës prof..msc.M.Sh..msc.A. M.,msc.R. H..

Sipas propozimit të dëmtuarës K., përfaqësuesit të autorizuar A. K. në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar prof..msc.M.Sh. i cili ka dhënë ekspertizën lidhur me këtë qeshje juridiko penale, i cili deklaroi: se detyrat i kemi marrë nga ana e Gjykatës që të bëjmë verifikimin e njehsorit elektrik, se a është keqpërdorë nga pronari i njehsorit, dhe në bazë të shqyrtimit analizës së pllombave nuk kemi gjetur ndonjë ndërhyrje nga pala e shfrytëzimit të njehsorit elektrik dhe pastaj nga puna e bërë e kemi nxjerrë elaborimin dhe e kemi përshkruar në tërësi në ekspertizën të cilën e kemi dorëzuar pranë gjykatës, kemi pasur mungesë të transaksionit të energjisë elektrike të pronarit por edhe ato na i ka siguruar gjykata kështu që në bazë të krahasimit të shpenzimit të energjisë elektrike nuk ka diferenca të mëdha në krahasim me njehsorin paraprak dhe me njehsorin e rij si grup matës. Në bazë të shikimit të njehsorit në çka kemi mundur të konstatojmë me sy duke shikuar pllombat, duke marrë parasysh se për të ndërhyrë në njehsor digjital duhet të jetë një person i cili është i përgatitur profesionalisht i cili e njehë kodin e njehsorit elektrik për të mundur me ndërhyrë dhe me manipuluar me njehsor elektrik, shton se në njehsor elektrik nuk ka pasur ndërhyrje, nuk është vërejtë ndërhyrje në pllombat industriale. Duke u bazuar se njehsorët elektrik janë digjital dhe pa e njohur kodin nga prodhuesit nuk ka mundësi që të ndërhyrë një njehsor elektrik, këtë konstatim e kemi prua në bazë edhe të transaksioneve të shpenzimeve të energjisë elektrike më parë edhe pas. Në pyetjen e Prokurores se sipas jush licencimi i rastit konkret a duhet me qenë eksperti i caktuar me licencë të caktuar i lëshuar nga MTI dhe a keni pasur ju atë drejtë dhe njohur në bazë të licencës juaj për të përpiluar këtë ekspertizë, i njëjti deklaroi se në si inxhinier i elektroenergjetikës kemi marrë urdhëresë nga gjykata dhe në bazë të detyrës së dhënë e kemi bërë analizën e njehsorit e cila i është bashkëngjitur në shkresat e lëndës dhe kemi sjellë mendimin përfundimtar në lidhje me detyrën e dhënë, hulumtimin dhe analizën e njehsorit elektrik e kemi bërë në kabinetin e instalimeve elektrike të firmës “Elektro Wati” me seli në Prishtinë – Pallati i rinisë, aty së bashku me kolegët në fjalë e kemi bërë analizën shqyrtimin se a ka pasur mundësi të ndërhyrjes në këtë njehsor elektrik, në mënyrë që ky të bëjë me fjalë tjera zvogëlimin e shpenzimeve elektrike sikurse ka ndodhur më parë me njehsor mekanik duke e bllokuar diskun me ndihmën e shiritit filmik

,licencën që e kemi marr për të kryer ekspertizën e njehsorëve elektrik, nuk e kemi pasur të specifikuese në asnjë drejtim të cilët njehsor elektrik obligohem që të kryej ekspertizën. Shton se une si ekspert kam kryer ekspertiza të njehsorëve elektrik mekanik dhe digjital, ndërsa për ndërhyrjen softwerike kjo është ekspertiza e parë që e kam kryer. Deklaron se ne e kemi pasur për detyrë që të bëjmë analizën e njehsorit elektrik se a ka pasur ndërhyrje në lidhjen e pikave përkatëse ku lidhë përçuesit nuk kemi pa ndonjë ndërhyrje nga jashtë që ka rezultuar si keqpërdorim i njehsorit elektrik, çka e kemi vërtetuar me pastaj me shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik. Ne pyetjen e Gjyqtarës se sipas jush ekspertizën që e keni dhënë ju tre ekspert të elektroenergjetikës a është ekspertizë apo super ekspertizë, i njëjti deklaroi se pasi që është dhënë mendimi nga tre anëtarë si ekspert të elektroenergjetikës është super ekspertizë po ta kisha dhënë unë si person i vetëm është vetëm ekspertizë, shton se ekspertizën për ndërhyrje softwerike të njehsorit elektrik, përpos neve mund të jepe edhe prodhuesi i njehsorit që e njuh kodin si dhe personi i autorizuar dhe i specializuar për natyrë të tillë si dhe agjensioni i metrologjisë të Kosovës të cilët janë të licencuar për këtë.

Sipas propozimit të prokurores se çështjes dhe pajtimit të palëve tjera në procedurë është aprovuar propozimi që për këtë çështje juridiko penale të caktohet edhe një ekspertizë e re nga agjensioni i metrologjisë së Kosovës në Prishtinë, pasi që sipas prokurores së shtetit Mone Sylja, eksperti i elektroenergjetikës M.Sh. deklaroi se përpos neve mund të jepe ekspertizë si eksperta të licencuar për ndërhyrje softwerike edhe anëtarët e AMT në Prishtinë. Në bazë të urdhërësës sonë në Gjykatë kemi pranuar ekspertizën e kryer nga ekspertet e AMT në Prishtinë, V. A. dhe ekspertja D. H..

Sipas propozimit të dëmtuarës K., përfaqësuesit të autorizuar Arber Krasniqi në cilësi të dëshmitarës është dëgjuar ekspertja e AMT në Prishtinë, V. A. e cila deklaroi: Sa i përket rastit konkret që është paraqitur nuk ka qenë e mundur ndryshimi i programit në program dhe në parametrave të regjistruar të obis kodit, andaj rasti konkret nuk ka qenë e mundur me ndërhyrje dhe me i bërë këto ndryshime përpos prodhuesit siç është rasti konkret njehsori i prodhuar në fabrikën e Iskres në Slloveni. Mundësit që mundën me i bërë janë hakerat e ndryshëm që për ne janë të panjohura ato nuk i dimë, ne nuk kemi pasur kesi rasti që personi fizik të ndërhyjë në njehsor elektrik. Obis kodi janë parametrat në displej të njehsorit siç janë tarifa T0 e shpenzimit të energjisë totale T1 tarifa gjatë ditës dhe T2 tarifa e natës dhe T3 dhe T4 janë tarifa jo aktive (pasive). Sa i përket shqyrtimeve dhe leximit softwerike i kryejnë punëtorët e K., gjersa punëtorët e AMK kryejnë vetëm leximin e ID të njehsorit si dhe merret me parametrat e saktësisë së njehsorit dmth. sipas standardeve. Ne si AMK nuk mund të vërtetojmë leximin e softwerike të programit në hollësi këtë e bënë vetëm zyrtarët e K., neve kemi vërtetuar se ky njehsor nuk e ka pas në displej në tarifën T0 dhe T4, gjë që prodhuesi ka deklaruar se në softwer të programit ka ndryshime të programit softwerike e këtë e bënë vetëm prodhuesi, në këtë nuk mundet me ndërhyrje askush, e në këtë rast konkret tarifën T0 dhe T4 nuk kanë qenë të dukshme, për këtë arsye edhe është dhënë konstatimi në ekspertizë se ndërhyrja në këtë njehsor është vetëm nga prodhuesi ose mund të jetë ndonjë defekt në njehsor gjatë punës së njehsorit ose gjatë prodhimit. Ne në departamentin tonë testojmë njehsorin në klasa të saktësisë si dhe leximin e ID të njehsorit të programit softwerik, prandaj edhe për këtë njehsor elektrik kemi bërë ekspertizën dhe e kemi dhënë mendimin përfundimtar. Ky njehsor elektrik ka bërë matjen e energjisë elektrike të shpenzuar, shpenzimi i energjisë elektrike është regjistruar në T1 dhe T2, këto të dyja mblidhen dhe shuma totale del në T0, ndërsa T4 ka qenë pasive dhe T0, respektivisht T0 dhe T4 ka munguar në njehsor, edhe pse ka munguar T0, ka mundur të faturohet shpenzimi i energjisë elektrike, pasi që mblidhen shpenzimi i energjisë në T1 dhe T2, mirëpo ka mundësi që mos të lexohen në totale, por T1 dhe T2 lexohen dhe kanë ekzistuar. Por ngacmimin në softwer, siç cekta edhe më lartë këtë mund ta bënë vetëm prodhuesi. Ne pyetjen e prokurores se më parë a

keni përpiluar ndonjëherë ndonjë ekspertizë në lidhje me llogarinë e dëmtimit të softwerit apo ndërhyrjet në softwer,e njëjta deklaror se nuk kanë pasur asnjë kërkesë gjer me tani të kësaj natyre ,zakonisht kërkesat kanë qenë nën dyshimin e matjes të pasaktë të njehsorit, dhe për këto raste kam dhënë shumë ekspertiza, unë si zyrtare e metrologjisë bëjë dhe e kam detyrë të punës me bë leximin e ID të softwerit siç e kam bërë në rastin konkret, unë jam e certifikuar nga IMK Slloveni për njehsorë elektronik si zyrtare e metrologjisë në Prishtinë për të lexuar ID e softwerit dhe matjen e saktësisë së njehsorit, ndërsa për ndërhyrje më detale mund ta konstatoj vetëm K., prandaj edhe për rastin konkret kam dhënë mendimin si eksperte se vetëm prodhuesi mundet me ndërhyrë dhe me i ndryshua parametrat e obis kodit e kurrsesi personi fizik, ose eventualisht ndonjë haker tepër i specializuar.

Provat materiale

Nga procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me numër 0672073 të datës 30.01.2017 lëshuar nga K.-Distrikti në Gjakovë, Gjykata ka vërtetuar se punëtorët e autorizuar te K.-it kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik me nr.63841411,dhe kanë vendosur njehsorin e ri elektrik me nr.67266487.

Nga protokollin i shqyrtimit të njehsorit elektrik numër 02 nr.2299 të datës 14.02.2017 të lëshuar nga sektori i qendrës së kalibrimit Prishtinë, Gjykata ka vërtetuar se në njehsorin elektrik ka ndërhyrje në parametër skeme me dt.18.12.2016,ka shpenzime në T4,në display dhe leximi softuerike nuk paraqitet T0 dhe T4.Diferenca në mes T0 dhe T1,T2 është 2930 kwh.

Nga procesverbali me nr.13118277 të lëshuar nga K. – Distrikti në Gjakovë, Gjykata ka vërtetuar se punëtorët e K.-it, kanë konstatuar tek konsumatori Z. I. pajisjet elektrike të cekura në procesverbal që i ka në shtëpinë e tij.

Nga kalkulimi RH me numër të rastit 102849 datës 23.02.2017 lëshuar nga KES/C0 në Prishtinë – divizioni i furnizimit, Gjykata ka vërtetuar se punëtorët e autorizuar te KES/C0 në Prishtinë kanë konstatuar energjinë mujore për faturim të shpenzimit të paautorizuar.

Nga faturat mbi llogaritjen e dëmit me numër DGJ 17 HP06570 të datës 23.02.2017 lëshuar nga K. – Distrikti në Gjakovë, Gjykata ka vërtetuar se është bërë faturimi i rikthimeve të humbjes, i shpenzimit të energjisë elektrike të paautorizuar.

Nga shkresa e lëshuar nga M. Sh. – Drejtor i portofolit të produkteve të zonës ISKRAMECO dd, e lëshuar në Tetor të vitit 20, Gjykata ka vërtetuar se i ka njoftuar Kompaninë e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës, se njehsorët e prodhuar nga Kompania ISKRA, janë të dizajnuar për matjen e energjisë në nivelin me të lartë të klasës së saktësisë dhe për me shumë këta njehsor kanë aftësinë që të regjistrojnë dhe zbulojnë ngjarjet nga burimet të ndryshme të ndërhyrjes në njehsorë. Të gjitha ngjarjet që kanë

të bëjnë me aktivitetet e matjes janë të regjistruara në kutinë e njehsorit dhe ato lehtë mund të nxjerrin dhe të lexohen nga njehsori.

Nga ekspertiza e njehsorit elektrik me nr.63841411 e lëshuar nga ekspertët e elektroenergetikës Prov.msc.M.Sh., Msc.A. M. dhe msc.R. H. i dt.21.02.2020, Gjykata ka vërtetuar se të njëjtit kanë bërë ekspertizën e njehsorit elektrik me nr. 63841411 dhe kanë dhënë mendimin përfundimtar, me konstatim se :Faturimi për rikthimin e humbjeve të energjisë

elektrike është bere ne kundërshtim me te gjitha procedurat e miratuara nga ZRRE-ja. Ndërhyrja nga ana e konsumatorit është e pamundur për shkak te mos njohurive profesionale te tij. Nuk është marr për baze rrjedha e energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit te njehsorit elektrik(transaksionet e konsumatorit).Prandaj duke u bazuar ne këto konstatime, grupi i eksperteve konkludon se faturimi i rikthimit te humbjeve te energjisë elektrike nga K.-i është i pa bazuar.

Nga ekspertiza e njehsorit elektrik me nr.63841411 tipit MTI74 i prodhuesit Iskra në Slloveni, e lëshuar nga Agjensioni i metrologjisë së Kosovës me dt.25.08.2020 Gjykata ka vërtetuar se ekspertet e AMK, V. A. dhe D. H. kane dhëne mendimin përfundimtar pas ekspertizës se bere te këtij njehsori me konstatim se, duke u bazuar ne leximin e programit softuerik te njehsorit elektronik me nr.serik 63841411 tipit MTI74 i prodhuesit Iskra në Slloveni, ekziston mundësia e paraqitjes se defektit ne njehsorin elektronik. Përndryshe mundësia e ndërhyrjes ne program softuerik është e mundur vetëm nga ana e prodhuesit, ne rastin ne fjale prodhuesi "Iskra"-Slloveni.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari Z. I. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: më kujtohet shumë mirë rasti, kur në shtëpinë time kanë ardh katër punëtor të K. dhe më janë drejtuar duke më thënë jemi të autorizuar që heqim njehsorin elektrik të juaj, unë i kam thënë se e kam njehsorin digjital dhe ma keni ndërruar njehsorin, ata më janë përgjigjur se duhemi përsëri me e ndërrua këtë njehsor, i kam pyetur se për çfarë arsyeje dëshironi me e ndërrua njehsorin, ata më kanë thënë se edhe ne nuk e dijm për çfarë arsye por jemi të autorizuar prej K.-it, unë nuk kam kundërshtuar dhe ata kanë bërë ndërrimin e njehsorit. Procesi i cili është përpiluar në vendin e ngjarjes, e kam nënshkruar unë vete, paraprakisht e kam lexuar, dhe aty shkruan se vetëm është bërë ndërrimi i njehsorit për të cilën edhe unë jam pajtuar dhe e kam nënshkruar procesin. Njehsorin në momentin kur ma kanë hekë e kanë vendosur njehsorin e ri, por atë njehsorin e mëparshëm nuk e kam parë. Ne pyetjen se a të kujtohet sa i keni pasur faturat para se të ndërrohet njehsori dhe pas ndërrimit të njehsorit dhe a kanë ndryshim, i njëjti deklaroi se nuk kam pasur ndryshim, pagesën për afërsisht e kam pasur të njëjtë dhe si provë ia prezantoi gjykatës fletë pagesat të bëra para dhe pas ndërrimit të njehsorit. Ne pyetjen e Gjyqtares deklaroi se e kam të kryer shkollën e mesme ekonomike, punoi si zjarrfikës – vozitës dhe nuk kam aspak njohuri kompjuterike, kompjuterin dije vetëm ta aktivizoi të dëgjoj muzikë apo të luaj me letra. Shton se nuk jam në dijeni se si ka ardh deri te ky çrregullim i njehsorit, por ju betohem se unë nuk kam ndërhyrë në këtë njehsor elektrik, dhe nuk kam njohuri të bëjë këtë manovrim dhe nuk kisha me e bërë edhe po të kisha njohuri se jam familjar dhe qytetar i ndershëm, po ta kisha bërë që në fillim e kisha pranuar në gjykatë, për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër penale, nuk kam qenë në gjykatë para lufte dhe as pas lufte.

Elementet e veprës penale

Në nenin 314 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprën penale vjedhje e shërbimeve e kryejnë: *“kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre(3) vjet, ndërsa në par.6 të po këtij neni,*

parashifet “për qëllim të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit ,ujit ,rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes , pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar. ” nga kjo del se elementet e kësaj vepre janë konsumuar vetëm kur kryhet me dashje me veprim. Andaj, lidhur me pretendimet e prokurorit se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, Gjykata pas administrimit të provave, me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj veprimet e të akuzuarit që të ketë kryer këtë vepër penale për të cilën pretendon prokuroria, nuk ka arritur ta vërtetoj që manipulimi në fjalë është kryer me veprimet e të akuzuarit, andaj edhe të njëjtin e ka liruar nga aktakuza.

- Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari Z. I. ka bere ndërhyrje ne njehsorin e tij elektrik digjital, nuk janë vërtetuar veprimet dhe përgjegjësia e tij penale. Gjykata këtë e ka vërtetuar ne baze te deklaratës se te akuzuarit Z. I. te cilës deklaratë Gjykata ia fali besimin e plote sepse deklarata e tij ishte ne përputhje te plote me dëshminë e dëshmitarëve dhe provave tjera materiale që u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor. Vetë punëtorët e autorizuar të Qendrës së Kalibrimit, V. P. dhe T. M., deklaruan se për te ndërhyj ne parametër skeme për te manipuluar me softverin e njehsorit elektrik, fillimisht duhet të thyhet passwordi i softverit pastaj të bëhet ndërhyrja dhe këtë passwordin e kanë vetëm fabrika e njehsorëve dhe një ndërhyrje të tillë e konsiderojnë si një proces shumë të ndërlikuar. Një ndërhyrje e tillë duhet të bëhet me llaptop dhe me mjete elektrike si sonda, nga një person i cili ka njohuri tejet profesionale kompjuterike. Gjykata dëshmime te tyre iu fali besimin sepse deklaratat e tyre ishin ne përputhshmëri edhe me super ekspertizën e njehsorit elektrik me nr.63841411 e lëshuar nga ekspertët e elektroenergjetikës Prov.msc.M.Sh., Msc.A. M. dhe msc.R. H. i dt.21.02.2020, te cilët kane dhënë mendimin përfundimtar, me konstatim se : ndërhyrja nga ana e konsumatorit është e pamundur për shkak te mos njohurive profesionale te tij, si dhe nuk është marr për baze rrjedha e energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit te njehsorit elektrik(transaksionet e konsumatorit) prandaj duke u bazuar ne këto konstatime, grupi i eksperteve konkludon se faturimi i rikthimit te humbjeve te energjisë elektrike nga K.-i është i pa bazuar. Gjithashtu Gjykata mos përgjegjësinë e te akuzuarit për këtë vepër penale e vërtetoi edhe nga ekspertiza e njehsorit elektrik me nr.63841411 tipit MTI74 i prodhuesit Iskra në Slloveni, e lëshuar nga Agjensioni i metrologjisë së Kosovës me dt.25.08.2020 ku ekspertet e AMK, V. A. dhe D. H. kane dhëne mendimin përfundimtar pas ekspertizës se bere te këtij njehsori me konstatim se, duke u bazuar ne leximin e programit softuerik te njehsorit elektronik me nr.serik 63841411 tipit MTI74 i prodhuesit Iskra në Slloveni, ekziston mundësia e paraqitjes se defektit ne njehsorin elektronik. Përndryshe mundësia e ndërhyrjes ne program softuerik është e mundur vetëm nga ana e prodhuesit, ne rastin ne fjale prodhuesi ”Iskra”-Slloveni. Eksperti Prov.msc.M.Sh. dhe ekspertja e AMK-ës ne deklaratat e tyre te dhëna gjate shqyrtimit gjyqësor kane qëndruar ne tersi ne ekspertizat qe i kane dhënë për këtë çështje juridiko penale, deklaratave të tyre Gjykata iu fali besimin e plotë sepse të njëjtit janë ekspert të lëmis përkatëse. Gjykata vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve punëtorëve te autorizuar te K.-it, L. M. dhe Nd. Dh. te cilët ngjajshëm deklaruan se na është dhënë urdhër që të bëjmë ndërrimin e njehsorit elektrik pasi që nga ana e lexuesit përmes pajisjes sonda(leximi i njehsorit elektrik)është konstatuar ndërhyrje në këtë njehsor, më qëllim që ta dërgojmë në qendrën e kalibrimit, gjatë ndërrimit të njehsorit ne nga ana e jashtme nuk kemi vërejte ndonjë ndërhyrje I akuzuari ka qenë prezent dhe ka nënshkruar procesverbalin, nga deklaratat e tyre Gjykata vërtetoi se te njëjtit kane qene prezent kur kane bere ndërrimin e njehsorit ashtu siç ka deklaruar edhe vete i akuzuari. Gjykata

vlerësoi edhe shkresën e lëshuar nga M. Sh. – Drejtor i portofolit të produkteve të zonës ISKRAMECO dd, e lëshuar në Tetor të vitit 20, me të cilën Gjykata ka vërtetuar se i njëjti i ka njoftuar Kompaninë e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike të Kosovës, se si janë të dizajnuar dhe si funksionojnë njehsorët e prodhuar nga Kompania ISKRA.

Ne baze të këtyre provave që u administruan në shqyrtimin gjyqësor edhe vete prokurorja e çështjes në fjalën përfundimtare deklaroi se tani në këtë fazë jam shumë e bindur se i akuzuari Z. I. nuk ka dijeni për të ndërhyrë vetë në njehsorin elektrik, por shton se neve gjer me tani në bazë të ekspertizave nuk kemi mundur që të vërtetojmë gjendjen faktike edhe pse vete e njëjta i ka propozuar këto ekspertiza për vërtetimin e gjendjes faktike. Por Gjykata pikërisht në baze të super ekspertizës dhe ekspertizës e lëshuar nga AMK-Prishtinë, vërtetoi se i akuzuari nuk ka ndërhyrë në parametër skeme për të manipuluar me softverin e njehsorit të tij elektrik, pasi që të njëjtit shumë qarte në mendimin e tyre përfundimtar kanë sqaruar se mundësia e ndërhyrjes në program softuerik është e mundur vetëm nga ana e prodhuesit, në rastin në fjale prodhuesi "Iskra"-Slloveni, duke mos e anashkaluar edhe mundësinë e paraqitjes së defektit në njehsorin elektronik.

Duke marrë parasysh këto prova gjykata vërtetoi se i akuzuari nuk ka ndërhyrë në parametër skeme për të manipuluar me softverin e njehsorit të tij elektrik, deri të ky konstatim erdhi edhe nga mbrojtja e të akuzuarit, i cili deklaroi se nuk ka fare njohuri kompjuterike e aq më pak për një ndërhyrje të tillë softverike, ka të kryer vetëm shkollën e mesme është punëtor, punon si vozitës din vetëm të aktivizoj kompjuterin, të luaj me lojëra dhe të dëgjon muzike. Andaj, Gjykata pas administrimit të provave, me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetojë veprimet e të akuzuarit që të ketë kryer këtë veprë penale për të cilën pretendon prokuroria, nuk ka arritur ta vërtetojë që manipulimi në fjalë është kryer me veprimet e të akuzuarit, andaj edhe të njëjtin e ka liruar nga aktakuza.

Vendimi për lirim të të akuzuarit nga akuza

Meqenëse nuk është vërtetuar me asnjë nga provat materiale dhe as nga dëshmitë e dëshmitarëve se i akuzuari Z. I. ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, Duke u bazuar në këto që u cekën më lart komform nenin 364, paragrafi 1 nën.paragrafi 1.3 të KPP, gjyqtarja e vetme gjyquese e liroi nga akuza të akuzuarin Z. I. për kryerjen e veprës penale, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.3 të KPPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e morri në mbështetje të nenet 454 par.1 të KPPK-së.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i përgjithshëm-
P. nr.60/19 të dt.12.02.2021

Sekretarja juridike
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina

KËSHILA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatë së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:019181
Datë: 23.02.2021
Numri i dokumentit: 01533472